



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0068098-2/24 dt. 23.10.2024
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Rregulloren MF Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Propozim-Vendimin Nr. 01-020/04-0068098/24, dt. 14.10.2024 të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Kryetari i Komunës sjell këtë:


V E N D I M

(Për Formimin e Komisionit për Evidentim të Inventarit)

1. **Formohet** Komisioni për Evidentimin/Inventarizimin e Pasurive jo Financiare të Inventarit të Komunës në këtë përbërje:
 - 1.1 Egzon Aliu – Kryetar, (Drejtorja për Buxhet dhe Financa);
 - 1.2 Agon Bytyqi – Anëtar, (Drejtorja e Arsimit);
 - 1.3 Vlora Haxhiu – Anëtare, (Drejtorja për Administratë të Përgjithshme).
2. Komisioni ka për detyrë verifikimin e gjendjes faktike të inventarit në objektin e Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe të objekteve tjera të cilat menaxhohen nga Komuna duke përfshirë inventarizimin e të gjithë pasurisë jo financiare që është në pronësi dhe kontrollë të Komunës, verifikimi fizik dhe cilësor i gjendjes së pasurisë jo financiare, krahasimi i gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare, identifikimi i pasurisë që nuk ka vlerë të bartur, identifikimi i pasurive të dëmtuara dhe jashtë përdorimit si dhe evidenca e stokeve në depo, si dhe evidentimin e të gjitha automjeteve që janë në dispozicion të Komunës.
3. Komisioni obligohet që të përgatitë Raport për kryerjen e inventarizimit, hartimin e raportit të përgjithshëm duke u bazuar në raportet individuale të Komisionit për inventarizimin e pasurisë jo financiare, dhe krejt kjo duhet të përmbyllet deri me datën 31.12.2024.
4. Komisioni bazë për punën e tij do të ketë Rregulloren MF – Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.

Handwritten signature

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës

Bedri HAMZA



Shtojcë:

1x1 Propozim-Vendimin Nr. 01-020/04-0068098/24, dt. 14.10.2024 i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

T'i dorëzohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës së Informimit
- 1x1 Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- 1x1 Anëtarëve të Komisionit
- 1x1 Arkivit.

